

# 2026



UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS

# UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE GJENERATIVE

për studentët e  
Universitetit të Prishtinës

Versioni 1.0

1970 MCMLXX

# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	3
PJESA 1	6
Qëllimi i udhëzuesit	7
Pse ky udhëzues është i nevojshëm	7
Kujt i dedikohet ky udhëzues	7
Qëndrimi i UP ndaj përdorimit të GenAI	8
PJESA 2	9
Inteligjenca Artificiale Gjenerative	10
Funksioni gjeneral i GenAI	10
Çfarë mund të bëjë GenAI	11
PJESA 3	12
Parimet themelore	13
Përdorimi i GenAI sipas kategorieve (modeli “Semafor”)	14
Vetëvlerësimi i përdorimit të GenAI sipas kategorieve	15
PJESA 4	17
Deklarimi dhe citimi i përdorimit të GenAI	18
Verifikimi dhe përgjegjësia	18
PJESA 5	19
Procedurat në rast të mosrespektimit të udhëzuesit	20
PJESA 6	21
Përditësimi i udhëzuesit	22
REFERENCAT	23
SHTOJCA 1: Lista e kontrollit për studentët	24
SHTOJCA 2: Dokumenti që duhet vendosur në punën e studentëve	25

# LISTA E SHKURTESAVE

AI	Artificial Intelligence (Inteligjencë Artificiale)
ANN	Artificial Neural Networks (Rrjete Nervore Artificiale)
EU AI Act	European Union Artificial Intelligence Act (Akti i Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale)
FEdu	Fakulteti i Edukimit
GAN	Generative Adversarial Networks (Rrjete Gjeneruese Kundërshtuese)
GenAI	Generative Artificial Intelligence (Inteligjencë Artificiale Gjenerative)
GPT	Generative Pre-trained Transformer
IA	Inteligjencë Artificiale
LLM	Large Language Models (Modele të Mëdha Gjuhësore)
ML	Machine Learning (Mësim Makinerik)
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë)



# Udhëzuesi është i strukturuar në gjashtë pjesë, siç është përshkruar më poshtë:

**PJESA E PARË** e udhëzuesit vendos bazën konceptuale dhe institucionale të dokumentit, duke shpjeguar qëllimin e tij, arsyet pse një udhëzues i tillë është i domosdoshëm në realitetin aktual akademik dhe qëndrimin e Universitetit të Prishtinës ndaj përdorimit të Inteligjencës Artificiale Gjenerative.

**PJESA E DYTË** ka për qëllim të ofrojë një kuptim bazik dhe të qasshëm mbi atë se çfarë është Inteligjenca Artificiale Gjenerative dhe si funksionon ajo. Pa hyrë në thellësi teknike, kjo pjesë shpjegon se GenAI është një teknologji që gjeneron përmbajtje të re bazuar në të dhëna ekzistuese dhe kërkesa të përdoruesit, por që nuk posedon kuptim njerëzor.

**PJESA E TRETË** përqendrohet në parimet themelore që duhet të udhëheqin përdorimin e GenAI në kontekst akademik dhe në modelin e përdorimit sipas kategorive, të njohur si modeli "Semafor". Kjo pjesë përcakton qartë se integriteti akademik, transparencja, përgjegjësia personale, verifikimi kritik dhe respektimi i privatësisë dhe të drejtës së autorit janë parime të panegociueshme. Përmes modelit të semaforit, udhëzuesi ofron një kornizë praktike për klasifikimin e përdorimit të GenAI në kategori të kuqe, portokalli dhe të gjelbër, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë se çfarë lejohet, çfarë kufizohet dhe çfarë inkurajohet në varësi të llojit të vlerësimit.

**PJESA E KATËRT** trajton çështjet e deklaramit, citimit dhe verifikimit të përdorimit të GenAI. Kjo pjesë thekson se transparencja është thelbësore për ruajtjen e integritetit akademik dhe se çdo përdorim i GenAI duhet të deklarohet qartë, të dokumentohet dhe të shoqërohet me ruajtjen e deklaratave dhe rezultateve. Parimi "beso, por verifiko" shërben si udhërrëfyes për studentët, duke theksuar nevojën për kontroll kritik të çdo përmbajtjeje të gjeneruar dhe shmangien e përdorimit të referencave ose informacionit të pasaktë.

**PJESA E PESTË** fokusohet në pasojat dhe procedurat në rast të mosrespektimit të udhëzuesit. Ajo qartëson se shkeljet mund të çojnë në masa disiplinore dhe se besimi ndërmjet studentit dhe stafit akademik është një element thelbësor që duhet mbrojtur.

**PJESA E GJASHTË** thekson karakterin dinamik të udhëzuesit dhe nevojën për përditësim të vazhdueshëm. Duke qenë se teknologjitë e inteligjencës artificiale zhvillohen me ritme të shpejta, kjo pjesë përcakton angazhimin se udhëzuesi do të rishikohet periodikisht në bashkëpunim me departamentet dhe organet vendimmarrëse të Universitetit.

Në fund, **shtojcat** shërbejnë si instrumente praktike që e bëjnë udhëzuesin të zbatueshëm në praktikë. Lista e kontrollit për studentët synon të nxisë vetëreflektimin dhe vetëdijen akademike para dorëzimit të çdo pune, ndërsa deklarata mbi përdorimin e GenAI siguron transparencë dhe dokumentim të qartë të përdorimit të kësaj teknologjie.



# PJESA 1

Ky udhëzues është ndërtuar mbi një qasje evropiane dhe ndërkombëtare të harmonizuar për përdorimin e Inteligjencës Artificiale Gjenerative në arsim, duke reflektuar parimet e EU AI Act, rekomandimet e OECD, UNESCO, udhëzimet etike për kërkim shkencor dhe praktikat më të mira të universiteteve evropian, britanike dhe amerikane.

## QËLLIMI I

## UDHËZUESIT

Qëllimi kryesor nuk është ndalimi i përdorimit të Inteligjencës Artificiale Gjenerative (tutje GenAI), por ndërtimi i kapaciteteve të studentëve për përdorim kritik, etik dhe të ndërgjegjshëm të GenAI, në përputhje me misionin e Universitetit të Prishtinës dhe integritetin akademik.

## PSE KY UDHËZUES ËSHTË I NEVOJSHËM

Zhvillimi dhe përhapja e shpejtë e Inteligjencës Artificiale Gjenerative (GenAI) ka krijuar një realitet të ri akademik, ku kufijtë ndërmjet mbështetjes së GenAI dhe zëvendësimit të kontributit njerëzor mund të bëhen të paqartë. Dokumentet evropiane dhe ndërkombëtare theksojnë se rreziku kryesor nuk qëndron tek vetë teknologjia, por tek përdorimi i saj pa vetëdije, pa transparencë dhe pa përgjegjësi [1-7].

Sipas udhëzimeve të Komitetit të Etikës të Instituti Universitar Evropian [3], përdorimi i AI në kërkim dhe mësimdhënie duhet të mbështetet në kompetencë mbi AI, vetëdije dhe përgjegjësi individuale, duke pranuar se përdoruesi, në këtë rast studenti, mbetet gjithmonë përgjegjës për përmbajtjen, argumentimin dhe integritetin e punës së tij. Kjo qasje reflektohet edhe në udhëzimet e Komisionit Evropian për përdorimin e përgjegjshëm të GenAI në kërkim, të cilat e trajtojnë AI si një mjet mbështetës dhe jo si autor apo vendimmarrës [4].

Në të njëjtën kohë, kornizat globale të UNESCO-s dhe OECD-së theksojnë se kompetenca mbi AI nuk është vetëm aftësi teknike, por një kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve etike që u mundësojnë studentëve të kuptojnë ndikimet shoqërore, kulturore dhe akademike të IA [5, 6, 7].

## KUJT I DEDIKOHET UDHËZUESI

Ky udhëzues synon t'i mbështesë studentët e Universitetit të Prishtinës, në përdorimin e Inteligjencës Artificiale Gjenerative (GenAI) në mënyrë etike, transparente dhe të përgjegjshme, duke ruajtur integritetin akademik, origjinalitetin e punës dhe zhvillimin e mendimit kritik.

Në këtë kuadër, GenAI konceptohet si një mjet mbështetës për procesin e të nxënimit dhe krijimit akademik, dhe jo si zëvendësim i kontributit intelektual dhe përgjegjësisë akademike të studentit.

Andaj, specifikisht ky udhëzues, i dedikohet studentëve të studimeve bachelor, master dhe doktoratë, të të gjitha programeve të studimit, duke përfshirë punën e tyre në të gjitha format e vlerësimit: ese, projekte, raporte, prezantime, punime diplome, provime dhe të tjera.



Figura 2. Studentët e Universitetit të Prishtinës në Laboratorin STEAM

# QËNDRIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS NDAJ PËRDORIMIT TË GenAI

Universiteti i Prishtinës mban një qëndrim pozitiv ndaj përdorimit të përgjegjshëm të inteligjencës artificiale gjeneruese (GenAI) me qëndër njeriun (human-centered) në arsim, duke inkurajuar kreativitetin dhe qasjet inovative, ndërkohë që i jep përparësi përgjegjshmërisë, transparencës dhe përputhshmërisë me këtë udhëzues.

Qasja “me qëndër njeriun” synon që inteligjenca artificiale të vihet në shërbim të zhvillimit të aftësive njerëzore dhe ndërtimit të një të ardhmeje gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme, duke respektuar të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe diversitetin kulturor.

Në kontekstin arsimor, kjo nënkupton që Intelejjenca Artificiale duhet të kontribuojë në fuqizimin e kompetencave të individëve, të mbështesë bashkëpunimin efektiv ndërmjet njeriut dhe teknologjisë, si dhe të garantojë qasje të barabartë për të gjithë. Në praktikë, kjo përfshin promovimin e qasjeve gjithëpërfshirëse në mësim, mbështetjen e mësimin të personalizuar, menaxhimin e përgjegjshëm të të dhënave, monitorimin e proceseve mësimore dhe zhvillimin e njohurive për përdorim etik dhe kritik të inteligjencës artificiale.

Universiteti i Prishtinës mbështet studentët në zhvillimin e aftësive të avancuara për punë me inteligjencën artificiale gjeneruese, përmes ofrimit të kurseve të pilotuara në Fakultetin e Edukimit, në përputhje me Kornizën e Kompetencave për Mësimdhënësit dhe Studentët në lidhje me Intelejjenca Artificiale, të dizajnuar nga UNESCO [6, 7].



# PJESA 2

Inteligjenca Artificiale Gjenerative është teknologji që mundëson krijimin e përmbajtjes së re: tekst, kod, imazhe, audio apo video, në bazë të kërkesave ose udhëzimeve të përdoruesit. Shembuj tipikë përfshijnë chatbot-e për gjenerim teksti, mjete për krijimin e kodit, aplikacione për prodhim imazhesh, si dhe sisteme për përmbledhje ose analizë dokumentesh.

Është thelbësore të theksohet se GenAI nuk “kupton” përmbajtjen në mënyrë njerëzore dhe funksionon përmes përpunimit statistik të të dhënave. Për pasojë, ajo mund të gjenerojë pasaktësi, paragjykime apo informacione të rreme. Përgjegjësia për verifikimin e saktësisë, besueshmërisë dhe vlefshmërisë së informacionit mbetet gjithmonë tek studenti.

# INTELIGJENCA ARTIFICIALE GJENERATIVE

## Funksioni gjeneral i GenAI

GenAI funksionon mbi bazën e kombinimit të inteligjencës artificiale dhe mësimin të makinerisë (Machine Learning – ML). ML përdor algoritme që i mundësojnë sistemit të përmirësohet në mënyrë automatike duke mësuar nga të dhënat. Sa më shumë të dhëna përpunohen, aq më mirë modeli arrin të identifikojë modele, struktura dhe lidhje, duke rritur saktësinë dhe efikasitetin e tij.

Një nga teknologjitë qendrore brenda ML janë rrjetet neurale artificiale (Artificial Neural Networks – ANN). Këto rrjete janë të frymëzuara nga funksionimi i trurit të njeriut, ku neuronet lidhen ndërmjet tyre për të përpunuar dhe transmetuar informacionin. Në mënyrë të thjeshtuar, ANN përbëhen nga shtresa “njësish” (neuronesh artificiale) që marrin të dhëna hyrëse, i përpunojnë ato dhe prodhojnë rezultate. Ekzistojnë arkitektura të ndryshme të rrjeteve neurale, dhe zgjedhja e tyre varet nga natyra e detyrës: gjenerim teksti, imazhesh, audio apo video.

Në rastin e përpunimit dhe gjenerimit të tekstit, shumë aplikacione të GenAI mbështeten në modele të mëdha gjuhësore – MMGj (Large Language Models – LLM).

Një shembull i njohur është GPT (Generative Pre-trained Transformer), i trajnuar paraprakisht mbi sasi shumë të mëdha të dhënash tekstuale. Falë këtij trajnimi, modeli është në gjendje të kuptojë kontekstin dhe të gjenerojë përmbajtje koherente, të strukturuar dhe semantikisht kuptimplotë.




Figura 3. Ku pozicionehen Modelet e Mëdha Gjuhësore brenda Inteligjencës Artificiale

Për gjenerimin e imazheve përdoren modele të avancuara të inteligjencës artificiale, kryesisht modele difuzioni dhe arkitektura si Generative Adversarial Network (GAN). Modelet e difuzionit krijojnë imazhe duke përmirësuar gradualisht zhurmën fillestare, ndërsa GAN-et funksionojnë përmes një procesi kundërshtues mes dy rrjeteve që gjenerojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen. Këto qasje mundësojnë prodhimin e imazheve gjithnjë e më realiste.

Në praktikë, kur përdoret një mjet për gjenerim teksti si ChatGPT, përdoren modele të tipit GPT; ndërsa aplikacionet që krijojnë imazhe shpesh bazohen në modele difuzioni ose arkitektura të ngjajshme gjeneruese. Përmes këtyre teknologjive, GenAI mund të prodhojë përmbajtje të larmishme, duke u përshtatur me kontekstin dhe kërkesën e përdoruesit.

## Çfarë mund të bëjë GenAI?

GenAI mund të shërbejë si një mjet mbështetës (asistent personal) me vlerë në procesin e të nxënit, mësimdhënies, kërkimit dhe punës akademike, kur përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe etike. Ajo nuk e zëvendëson mendimin njerëzor, por e mbështet dhe e fuqizon atë, duke ofruar asistencë teknike dhe njohëse në faza të ndryshme të punës intelektuale.

Në kontekstin arsimor, GenAI mund të ndihmojë studentët në gjenerimin e ideve, hartimin e skicave fillestare, strukturimin e përmbajtjes, si dhe në gjenerimin e kodit për analizë të të dhënave, ndër të tjera. Ajo mund të ofrojë shpjegime për koncepte komplekse dhe të sqarojë terminologji akademike në mënyrë më të qartë dhe të personalizuar, duke u përshtatur me nivelin e njohurive, shkathtësive dhe me stilet e ndryshme të të nxënit.



Figura 5. Integrimi i modeleve të mëdha gjuhësore në aplikacionet e përdorimit të përditshëm




Figura 4. Përdorimi i robotëve humanoid si asistentë personal të integruar me GenAI

Një dimension thelbësor i përdorimit të GenAI në arsim lidhet me zhvillimin e kompetencave digjitale dhe të mendimit kritik, në përputhje me theksin e vendosur në Kornizën e UNESCO-s për kompetencat e mësimdhënësve dhe studentëve në fushën e inteligjencës artificiale (UNESCO, 2024a; UNESCO, 2024b). Përdorimi i informuar dhe reflektiv i këtyre teknologjive kontribuon jo vetëm në përvetësimin e përmbajtjes, por edhe në formimin e një kulture akademike të përgjegjshme dhe etike.



# PJESA 3

Përdorimi i GenAI duhet të bëhet në përputhje me parimet themelore akademike dhe etike të institucionit, duke garantuar përdorim të përgjegjshëm, transparent dhe të sigurt.

Konkretisht:

- **Integritet akademik** – Puna e dorëzuar duhet të përfaqësojë mendimin, analizën dhe kontributin tuaj personal. GenAI mund të përdoret vetëm si mjet mbështetës, por nuk duhet të zëvendësojë punën tuaj akademike.
- **Transparencë** – Çdo përdorim i GenAI duhet të deklarohet qartë, sipas udhëzimeve të lëndës ose institucionit, duke integruar deklaratat që janë paraqitur në Shtojcën 1 dhe 2, të këtij dokumenti.
- **Përgjegjësi personale** – Studenti mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen finale të dorëzuar. Kjo përfshin saktësinë e informacionit, cilësinë akademike, si dhe përputhshmërinë me standardet etike dhe institucionale.
- **Verifikim kritik** – Çdo rezultat, sugjerim apo përmbajtje e gjeneruar nga GenAI duhet të shqyrtohet dhe të validohet në mënyrë kritike nga studentët.
- **Respektimi i privatësisë, GDPR-së dhe të drejtës së autorit** – Përdorimi i GenAI duhet të jetë në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)\*. Nuk duhet të futen në mjetet GenAI të dhëna personale, sensitive apo konfidenciale, si dhe të dhëna që nuk janë të përshtatshme për shërbimet cloud. Po ashtu, duhet të respektohen të drejtat e autorit dhe të shmangët përdorimi ose riprodhimi i përmbajtjes së mbrojtur pa citim ose autorizim të duhur.

Këto parime synojnë të sigurojnë që përdorimi i GenAI të mbështesë mësimin dhe zhvillimin akademik, duke ruajtur integritetin, sigurinë e të dhënave dhe përgjegjësinë individuale.


[\*] Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), <https://gdpr-info.eu/>

# PËRDORIMI I GENAI SIPAS KATEGORIVE (MODELI "SEMAFOR")

UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS

Sipas këtij udhëzuesi, përdorimi i GenAI klasifikohet në tri kategori, bazuar në modelin e "Semaforit" (shih Figura 6): (i) kategoria e kuqe - Nuk lejohet GenAI, (ii) kategoria e portokalltë - Lejohet GenAI sipas udhëzimeve të mësimdhënësve dhe (iii) kategoria e gjelbër - Lejohet GenAI.

Ky model synon të ofrojë qartësi normative dhe orientim praktik për studentët dhe stafin akademik, duke përcaktuar nivele të ndryshme të lejueshmërisë dhe përgjegjësisë në përdorimin e inteligjencës artificiale gjeneruese në kontekste mësimore dhe vlerësimi.



**Figura 6. Kategorizimi i përdorimit të GenAI sipas modelit semafor**

Për çdo detyrë, projekt apo provim, studenti duhet të jetë i informuar qartë se në cilën kategori të modelit të "Semaforit" bën pjesë përdorimi i GenAI. Kategoritë për secilin aktivitet mësimor përcaktohen nga mësimdhënësit, duke marrë parasysh qëllimet e të nxënit, natyrën e kompetencave që synohen të vlerësohen (njohuri, shkathtësi, qëndrime), nivelin e autonomisë së kërkuar nga studenti dhe llojin e vlerësimit (formativ apo sumativ).

Në varësi të kategorisë së lejuar të përdorimit, studentët janë të obliguar të ruajnë kërkesat e drejtuara ndaj GenAI (prompts), si dhe kopjen e rezultateve të gjeneruara, si pjesë e dokumentimit të procesit të punës së tyre. Ky dokumentim mund të kërkohej nga mësimdhënësi për verifikim dhe reflektim mbi mënyrën e përdorimit të mjetit. Kjo kërkesë synon të garantojë transparencë, gjurmueshmëri dhe integritet akademik në përdorimin e inteligjencës artificiale gjeneruese.

## **Vetëvlerësimi i përdorimit të GenAI sipas kategorive**


Profesorët e Universitetit të Prishtinës do të specifikojnë në syllabuset e tyre, për secilin instrument vlerësues, kategorinë përkatëse të përdorimit të GenAI, në përputhje me modelin e "Semaforit" dhe me objektivat e të nxënit të lëndës.

Studentët janë të obliguar të respektojnë kërkesat e përcaktuara në syllabus për çdo instrument vlerësues dhe të jenë të qartë për kategorinë në të cilën lejohet përdorimi i GenAI. Në rastet kur përdoret GenAI, ata duhet të ruajnë kërkesat/deklaratat e drejtuara ndaj sistemit (prompts), si dhe kopjen e rezultateve të gjeneruara, si pjesë e dokumentimit të procesit të punës dhe për qëllime transparence dhe verifikimi akademik.

# MODELI SEMAFOR

KATEGORIA	PËRSHKRIMI
	<p>Përdorimi i GenAI nuk lejohet në rastet vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Gjenerimi automatik i përmbajtjes akademike</b>, përfshirë hartimin e kapitujve të plotë apo të pjesshëm, analizave teorike ose empirike, gjenerimin e rezultateve kërkimore, interpretimin/analizën e të dhënave, formulimin e diskutimeve apo konkludimeve, si dhe parafrazimi përmbajtësor që zëvendëson mendimin origjinal, analizën dhe kontributin personal të studentit.</li><li>• <b>Gjatë provimeve të mbikëqyura në klasë</b>, përfshirë teste me shkrim, provime, kuize dhe forma të tjera të vlerësimit individual ku qëllimi është të vlerësohet drejtpërdrejt njohuria dhe performanca individuale autentike e studentit.</li><li>• <b>Në vlerësime që matin aftësi bazë akademike</b>, si shkrimi akademik dhe profesional, kompetencat gjuhësore, apo aftësitë matematikore dhe të llogaritjes, kur qëllimi i detyrës është të shihet nëse student i zotëron këto aftësi vetë, ndaj demonstrimi i drejtpërdrejtë i këtyre kompetencave duhet të vijë nga vetë studentit.</li><li>• Çdo përdorim i GenAI <b>pa deklaram të qartë dhe të dokumentuar</b>, pavarësisht qëllimit ose formës së përdorimit</li></ul>
	<p>GenAI mund të përdoret vetëm si mjet ndihmës, në përputhje të plotë me udhëzimet specifike të lëndës dhe pa zëvendësuar në asnjë rast punën intelektuale të studentit, dhe vetëm për qëllimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Hulumtim idesh</b> për projekte ose detyra, me qëllim nxitjen e mendimit fillestar, pa gjeneruar përmbajtje përfundimtare akademike.</li><li>• <b>Strukturimin teknik të përmbajtjes</b>, përfshirë organizimin e ideve, ndërtimin e skeletit të një pune,, renditjen logjike të kapitujve ose nënkaptujve, pa prodhuar tekst përfundimtar.</li><li>• <b>Shpjegime konceptuale dhe sqarime teorike</b>, me qëllim mbështetjen e të nxënit dhe kuptimit, jo për zëvendësimin e analizës së pavarur akademike.</li><li>• <b>Përkthim ose riformulim gjuhësor</b>, vetëm në funksion të qartësisë gjuhësore, korrektesisë gramatikore dhe stilistike, pa ndryshuar përmbajtjen konceptuale dhe pa shtuar ide, argumente apo analiza të reja.</li><li>• <b>Krijimin e materialeve vizuale, audio ose video</b>, për qëllime didaktike ose prezantuese, për aq kohë sa përmbajtja akademike bazë është prodhim origjinal i studentit, dhe GenAI nuk gjeneron argumentim, analiza ose konkluzione akademike.</li><li>• <b>GenAI nuk duhet të gjenerojë përmbajtjen akademike të punës</b> (tekst, argumente, analiza, rezultate, diskutime apo përfundime). Përgjegjësia për përmbajtjen, interpretimin dhe saktësinë akademike mbetet plotësisht te studentit.</li></ul> <p>Çdo përdorim i lejuar i GenAI <b>duhet të deklarohet</b> qartë në përputhje me udhëzimet e lëndës dhe të këtij udhëzuesi.</p>

# MODELI SEMAFOR

KATEGORIA	PËRSHKRIMI
	<p>Në raste të veçanta, GenAI mund të jetë pjesë e qëllimshme dhe e integruar e vlerësimit, vetëm kur kjo është qartësisht e specifikuar nga mësimdhënësit në syllabus, udhëzuesin e detyrës ose kriteret e vlerësimit.</p> <p>Në këtë kategori, lejohen të gjitha format e përdorimit të listuara në kategorinë e ndërmjetme (verdhë), si dhe përdorimet shtesë në vijim:</p> <p><b>Analizë kritike e rezultateve të gjeneruara nga GenAI, përfshirë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• vlerësimin e saktësisë,</li><li>• identifikimin e gabimeve, paragjyqimeve ose kufizimeve,</li><li>• reflektimin mbi cilësinë dhe besueshmërinë e output-it të GenAI.</li></ul> <p><b>Krahasim mes përmbajtjes njerëzore dhe asaj të gjeneruar nga GenAI, duke analizuar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• dallimet në argumentim,</li><li>• thellësinë konceptuale,</li><li>• koherencën, origjinalitetin dhe etikën akademike.</li></ul> <p><b>Projekte mbi përdorimin etik të Inteligjencës Artificiale, që trajtojnë çështje si:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• integriteti akademik,</li><li>• përgjegjësia profesionale,</li><li>• ndikimi i GenAI në arsim, shkencë dhe shoqëri.</li></ul> <p><b>Zhvillim aplikacionesh ose zgjidhjesh me GenAI, ku vlerësohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• konceptimi,</li><li>• dizajni,</li><li>• logjika e përdorimit,</li><li>• dhe reflektimi kritik mbi funksionimin e GenAI, jo përmbajtja e gjeneruar prej saj.</li></ul> <p><b>Korrektim gjuhësor, vetëm si mbështetje teknike, pa ndërhyrë në përmbajtjen konceptuale, argumentuese apo analitike.</b></p> <p>GenAI nuk duhet të gjenerojë përmbajtjen akademike përfundimtare (tekste, analiza, rezultate, diskutime apo konkluzione).</p> <p>Roli i GenAI kufizohet në objekt analize, mjet ndihmës ose komponent teknik, jo autor përmbajtjeje.</p> <p>Përgjegjësia akademike dhe intelektuale mbetet ekskluzivisht te studenti.</p> <p>Çdo përdorim i GenAI duhet të deklarohet qartë dhe të jetë i dokumentuar sipas këtij udhëzuesi.</p>

**Në të gjitha rastet e përdorimit të GenAI, studenti duhet të jetë në gjendje të mbrojë çdo pjesë të punimit.**



# PJESA 4

## DEKLARIMI DHE CITIMI I PËRDORIMIT TË GENAI

Në të gjitha rastet kur përdoret GenAI, studentët janë të obliguar të deklarojnë përdorimin e saj në mënyrë të qartë dhe transparente, duke integruar në punimin e tyre SHTOJCAT 1 dhe 2, ndërsa deklaratat/kërkesat e drejtuara ndaj GenAI (prompts) duhet të vendosen në një shtojcë të veçantë.

Kjo nënkupton se:

- Përdorimi i GenAI **duhet të deklarohet** në seksionin Mirënjohje ose Metodologji, varësisht nga natyra e punimit;
- Duhet të specifikohet **emri i mjetit, versioni dhe kompania ofruese;**
- Duhet të përshkruhet qartë **qëllimi i përdorimit** (p.sh., gjenerim idesh, strukturim përmbajtjeje, korrigjim gjuhësor, analizë kodi, etj.);
- Në një shtojcë të veçantë duhet të përfshihet **lista e plotë e deklaratave/kërkesave (prompts) të përdorura**, si dhe përmbledhja e rezultateve të gjeneruara nga GenAI.

Deklarimi i **prompts është i domosdoshëm** për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri të procesit të punës. Kjo lejon vlerësimin e saktë të kontributit të studentit dhe dallimin ndërmjet mendimit origjinal dhe mbështetjes së marrë nga sistemi.

### Shembull deklarami:

“Deklaroj përdorimin e ChatGPT-5.2 (OpenAI, <https://chat.openai.com/>) për të krijuar ide lidhur me temën e hulumtuar, si dhe për korrigjimin gjuhësor të versionit përfundimtar të punimit. Lista e plotë e kërkesave (prompts) të përdorura gjatë procesit është paraqitur në shtojcën përkatëse, së bashku me përmbledhjen e rezultateve të gjeneruara.”

Për udhëzime të detajuara, shih **SHTOJCAT 1 dhe 2**.

## VERIFIKIMI DHE PËRGJEGJËSIA

Studentët duhet të udhëhiqen nga parimi themelor: **“beso, por verifiko.”** Kjo do të thotë se çdo informacion i gjeneruar nga GenAI duhet të trajtohet si material , i cili kërkon kontroll të pavarur dhe verifikim nga burime të besueshme akademike.

- **Çdo përmbajtje e prodhuar me GenAI mbetet nën përgjegjësinë dhe gjykimin kritik të studentit.** Studenti është përgjegjës për validimin e saktësisë, besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së informacionit për kontekstin akademik. GenAI mund të gabojë, të thjeshtojë tej mase ose edhe të prodhojë përmbajtje jo të saktë.
- **Mos përdorni referenca që nuk ekzistojnë.** Modelet gjeneruese mund të krijojnë citime, autorë ose burime që duken reale, por që nuk janë të verifikueshme. Çdo referencë duhet të kontrollohet në databaza akademike ose burime zyrtare përpara përfshirjes në punim.
- **Mos ndani të dhëna personale, sensitive ose konfidenciale me asnjë mjet GenAI.** Kjo përfshin të dhëna të studentëve, pjesëmarrësve në hulumtime, dokumente institucionale të brendshme ose çdo informacion që mbrohet nga rregulloret e privatësisë dhe etikës kërkimore.

Në thelb, GenAI është një mjet ndihmës. Përgjegjësia akademike dhe etike mbetet gjithmonë tek përdoruesi.



# PJESA 5

# PROCEDURAT NË RAST TË MOSRESPEKTIMIT TË UDHËZUESIT

Ky udhëzues zbatohet në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit të Prishtinës, Kodin Etik të UP, si dhe me rregulloret për integritetin akademik dhe vlerësimin e studentëve. Aspektet etike të përdorimit të GenAI adresohen përmes “Deklaratës së Origjinalitetit”, e cila mbetet dokumenti bazë që garanton përgjegjësinë individuale të studentit për përmbajtjen e dorëzuar. Çdo shkelje, përfshirë përdorimin e mjeteve të paautorizuara ose mosdeklarimin e përdorimit të GenAI, do të trajtohet sipas masave disiplinore të përcaktuara në aktet në fuqi.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale Gjenerative konsiderohet pjesë e sjelljes akademike dhe, për rrjedhojë:

- Duhet të respektojë parimin e origjinalitetit dhe kontributit personal në punë;
- Nuk duhet të cenojë besimin profesional ndërmjet studentit dhe stafit akademik;
- Rastet e dyshuara mund të shqyrtohen nga Komisioni përkatës për shkelje të integritetit akademik;
- Mund të kërkohen sqarime shtesë, intervista verifikuese ose materiale mbështetëse (p.sh., versione pune, drafts, prompts të ruajtura).

Çdo përdorim i GenAI që bie ndesh me këto parime do të trajtohet në përputhje me procedurat formale dhe dispozitat e përcaktuara në rregulloret dhe aktet në fuqi të Universitetit të Prishtinës.



# PJESA 6

## PËRDITËSIMI I UDHËZUESIT

Ky udhëzues do të rishikohet në mënyrë periodike për t'u harmonizuar me zhvillimet teknologjike në fushën e inteligjencës artificiale, si dhe me ndryshimet në politikat dhe rregulloret institucionale.



Procesi i rishikimit do të realizohet në bashkëpunim me fakultetet brenda Universitetit të Prishtinës, strukturat për sigurimin e cilësisë dhe organet vendimmarrëse të universitetit, me qëllim garantimin e përditësimit, relevancës dhe koherencës së vazhdueshme të këtij udhëzuesi.

[1] ETHZ Zurich. (2024). Generative AI in Teaching & Learning Guidelines. Linku: [https://ethz.ch/content/dam/ethz/main/eth-zurich/education/ai\\_in\\_education/Generative%20AI%20in%20Teaching%20and%20Learning%20-%20Guidelines%20ETH.pdf](https://ethz.ch/content/dam/ethz/main/eth-zurich/education/ai_in_education/Generative%20AI%20in%20Teaching%20and%20Learning%20-%20Guidelines%20ETH.pdf)

[2] University of LEEDS. (2025). Generative AI guidance for taught students. Linku: <https://generative-ai.leeds.ac.uk/wp-content/uploads/sites/134/2023/12/UoL-GenAI-guidance-for-taught-students.pdf>

[3] European University Institute. (2024). EUI guidelines for the responsible use of artificial intelligence for research. European University Institute. Online: <https://www.eui.eu/Documents/ServicesAdmin/DeanOfStudies/ResearchEthics/2024.06-Ethics-Commitee-EUI-GENAI-DIGITAL.pdf>

[4] European Commission. (2025). Living guidelines on the responsible use of generative AI in research.

[5] UNESCO (2023). Guidance for generative AI in education and research. Linku: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000386693>

[6] UNESCO. (2024a). AI competency framework for students. Online: <https://www.unesco.org/en/articles/ai-competency-framework-students>

[7] UNESCO. (2024b). AI competency framework for teachers. Online: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000391104>

# SHTOJCA I: DEKLARATË MBI PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE GJENERATIVE (GENAI)

UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS

Emri dhe Mbiemri i studentit: \_\_\_\_\_

ID e studentit: \_\_\_\_\_

Fakulteti: \_\_\_\_\_

Programi: \_\_\_\_\_

Lënda : \_\_\_\_\_

Titulli i detyrës: \_\_\_\_\_

Data e dorëzimit: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

## Deklaratë

Unë, i/e nënshkruari/a, deklaroj se përdorimi i Inteligjencës Artificiale Gjenerative (GenAI) në këtë punë është bërë në përputhje me udhëzimet institucionale dhe parimet e integritetit akademik.

Përdorimi i GenAI

Nuk kam përdorur asnjë mjet të Inteligjencës Artificiale Gjenerative në përgatitjen e kësaj pune.

Kam përdorur mjete të Inteligjencës Artificiale Gjenerative në mënyrë të kufizuar dhe të deklaruar.

Në rast se kam përdorur GenAI, deklaroj se:

Kam kontrolluar udhëzimet e vlerësimit dhe përdorimi i GenAI lejohet për këtë detyrë sipas këtij udhëzimi.

Lista e plotë e kërkesave (prompts) të përdorura gjatë procesit është bashkëlidhur në shtojcë së bashku me përmbledhjet e rezultateve të gjeneruara.”

# SHTOJCA 2: LISTA E KONTROLLIT PËR STUDENTËT

Para dorëzimit të çdo detyre, pyes veten:

- Kam kontrolluar në syllabus ose kam konsultuar mësimdhënësin për të verifikuar nëse përdorimi i GenAI lejohet për këtë detyrë.
- Kam kuptuar rreziqet dhe kufizimet e përdorimit të GenAI, si paragjykimet, saktësinë, dhe përmbajtjen etike.
- Nuk kam dërguar informacione personale tek GenAI.
- Puna ime mbetet një punë e individuale dhe origjinale.
- Kam lexuar dhe kuptuar parimet e integritetit akademik për të shmangur plagjiaturën.
- Kam identifikuar dhe deklaruar qartë cila pjesë e kësaj pune është kontributi im intelektual.
- Kam verifikuar faktet dhe burimet që kam përdorur në GenAI.
- Kam deklaruar përdorimin e GenAI kur e kam përdorur.
- Kam përfshirë listën e deklaratave që janë përdorur nga GenAI si shtojcë.
- Do të isha në gjendje ta shpjegoja dhe mbroja këtë punë pa ndihmën e GenAI.
- Po veproj në përputhje me Kodin Etik të Universitetit të Prishtinës.

Këto deklaratat nuk janë mjet kontrolli, por instrument për zhvillimin e vetëdijes akademike dhe profesionale.

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

[rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

---

[www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

---

+383 38 244 183/244 186

---

Ky udhëzues është zhvilluar nga Fakulteti i Edukimit UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Hartuar nga grupi punues:

Prof. Asst. Krenare Pireva Nuci (kryesuese); Prof. Asst. Blerta Perolli Shehu;

Prof. Asoc. Kyvete Shatri; Prof. Asoc. Rozafa Ferizi Shala;

Prof. Dr. Eda Vula; Prof. Asoc. Teuta Danuza; Prof. Asst. Iliriana Tahiraj; Phd Linda Salihu;

PhdC Arian Musliu; Prof. Asst. Muhamet Pecj; Prof. Asoc. Blerim Saqipi

E licencuar sipas [CC BY-SA 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by-sa/4.0/)